



Nr. 61/6 prot.

Korçë, më 06.02.2023

PROCESVERBAL

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është përfshikim i bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT:

"Furnizim dhe instalim pompash dhe pajisjesh elektro-mekanike, në Stacionet e fshatrave Vreshtas, Veliternë, Kishnik (Podgorie), Shëngjergj, Plasë, si dhe në Stacionet Rajonale Plasë (Nj.A Pojan) dhe Bulgarec (Nj.A Libonik)."

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Pompa centrifugale; Instalime inxhinerike elektrike; Panele komadimi.

VLERA E FONDIT LIMIT:

26.500.000 (njëzetegjashtëmilionepesëqindmijë) leke pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr.162/2020 "Për prokurimin publik", nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", autoriteti kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë Sh.A (UKRK SH.A.) ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3 ,me vlerë 530.000 (pesëqindetridhjetëmijë) lekë (2% të vlerës së përllogaritur të kontratës).

K. Dishnica

V. Lubonja

R.Rezhda

Argumentimi: Kérkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.
b. Formulari përbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës 8.
c. Formulari i ofertës, sipas Shtojcës 1.
d. Formulari Lista e Çmimeve, sipas Shtojcës 2.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.1.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për 3 (tre) vitet e fundit financiare 2019, 2020, 2021 , ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 26.500.000 lekë.

Argumentimi: Kérkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet bazuar në dispozitat e sipërpërmendura ku përcaktohet:

Autoriteti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave **të xhiros vjetore** të realizuar nga operatori ekonomik dhe sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, **për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare**. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: b) **vlerën e përllogaritur të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar**.

Kérkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare **konsiderohet e përbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor**.

Kérkesa e mësipërme është në përpjesët im dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës. Ajo i shërben UKRK Sh.A , për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përbushjen me sukses të kontratës.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të këruara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 29, te Ligjit Nr. 8438, dt. 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat", i ndryshuar, ku përcaktohet: Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatushme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tativore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës,

Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislativit tativor, ku përcaktohen asfatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tativore).

K. Dishnica



V. Lubonja

R. Rezhda



2.2. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):
Operatori ekonomik duhet të ketë të përfshirë në objektin e veprimtarisë së tij, tregtimin dhe instalimin/vendosjen e mallrave objekt i këtij prokurimi, për vërtetimin e së cilit duhet të paraqesë Ekstraktin e Regjistrat Tregtar , të lëshuar nga QKB.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Kjo kërkesë është e lidhur ngushtë me objektin e kontrates që prokurohet dhe pra është e nevojshme për furnizimin dhe instalimin e pompave dhe pajisjeve elektro-mekanike, në stacionet e pompave

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi përfurnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 10 600 000 leke pa TVSH (40% të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate).

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik përfundimit të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme përfundimit të kontratës, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Për kontratat e mallrave vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

V. Lubonja

R.Rezhda



2023

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të janë ne vlerën si më sipër, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar ($40\% \times 26.500.000$ leke = $10.600.000$ leke pa TVSH). Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor UKRK SH.A., për aftësinë teknike të OE ofertues, nëpërmjet përvojave të duhura, që janë në përpjesetim me natyrën e objektit të prokurimit dhe që ka aftësinë e duhur për zbatimin e kontratës siç është parashikuar nga AK.

Shënim: *Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.*

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatë ISO 9001:2015 (*Sistemi i menaxhimit të cilësisë*) ose ekuivalent e vlefshme te akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njojur nga Republika e Shqipërisë.

- Operatori ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatë ISO 14001:2015 (*Sistemi i menaxhimit të mjedisit*) ose ekuivalent e vlefshme te akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njojur nga Republika e Shqipërisë.
- ISO 45001 (*Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë*) ose ekuivalent e vlefshme te akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njojur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, "Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor" të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", dhe nenin 40, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Për vet natyrën dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si furnizues dhe instalues të mallrave objekt i këtij prokurimi, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkua të cilësisë.

Sistemi i menaxhimit të cilësisë, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto çertifikata lidhet ngushtësish me objektin e kontratës dhe i shërbijnë autoritetit kontraktor për njojen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përbushjen e plotë të kontratës. Në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë çertifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkua të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesë Çertifikatë për Sistemin e manaxhimit të cilësisë ISO 9001 (e vlefshme) për të garantuar kërkuesat cilësore të mallrave objekt prokurimi dhe të instalimit të tyre, çertifikatë ISO 14001 për të garantuar ndikimet në mjedis, si dhe Çertifikatë per Sistemin e manaxhimit te shendetit dhe sigurimit ne pune OHSAS 18001 (e

V. Lubonja

R.Rezhda

vlefshme) ose Çertifikatën ekuivalente të njohur nga Standarde shqiptare ISO 45001-2018 për të garantuar sigurinë e punëtorëve gjatë instalimeve të mallrave.

Në rastet e bashkimit të operatoreve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet të dorezojë çertifikatat ISO sipas zërave të mallrave që do të marrë përsipër të furnizojet dhe instalojë sipas akt-marreveshjes. Në rast se çertifikata është në gjuhe të huaj operatori ekonomik duhet të paraqesë çertifikatën përkatëse, të përkthyer dhe të noterizuar.

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose autorizim nga distributori i autorizuar për mallrat objekt prokurimi, me emrin e objektit të prokurimit dhe nr.e references se procedures.

Në rast paraqitje të autorizimit nga distributori, OE duhet të paraqesë:

dokumentacion për të vërtetuar lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar, pra për të vërtetuar se subjekti në fjalë është distributor zyrtar .

Autorizimi duhet të përbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nennt 40, pika 5, gërmë a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,

Duke qënë se Autoriteti Kontraktor është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi është në të drejtën e tij të garantohet se oe pjesëmarrës dëshmojnë origjinalitetin e mallrave të furnizuara e rrjedhimisht i kërkon ofertuesve të paraqesin dokumentacion lidhur me origjinën e mallrave, të lëshuar direkt nga prodhuesi, ose distributori i autorizuar. Pra nëpërmjet këtij kriteri AK garantohet dhe fiton siguri se oe kontraktues do të përbushë me sukses kontratën.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat e PRODHUESIT ISO :9001-2015 dhe 14001, si dhe certifikatat e PRODHUESIT qe produktet dhe elementet janë te pershtatshme ne kontaktet me ujin e pijshem. Certifikata e përshtatshmërisë për ujë të pijshëm të pompave dhe motorëve elektrikë. Certifikatat duhet të lëshohen nga organet e mëposhtme evropiane të pavarura:

ACS– Vërtetim de Konformite Sanitaire – Francë

a Ministër i Sante - Drejtimi i Përgjithshëm i Sante DGS / SD7A N 571 i 11/2002 WRAS - Skema Këshilluese për Rregulloret e Ujit - Mbretëria e Bashkuar

V. Lubonja

R.Rezhda

b Material në kontakt me ujë të shëndetshëm për qëllime shtëpiake, duke përmبushur kërkosat e BS6920-1: 2000

DM 174 - Dekreti Ministror nr. 174 i datës 06/04/2007 përcakton kërkesat e materialeve të destinuara për t'u përdorur në kontakt me ujin e pijshëm – Itali

c Rregullorja sektoriale për lëshimin e certifikimit të cilësisë higjenike, Direktiva TIFQ BRE n.04 (ne perputhje me dokumentin normativ ICIM)

Ky kusht plotesohet vetem me një nga dokumentat e leshuara nga institucionet e lartpermendura.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 40, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesë certifikatat e PRODHUESIT ISO :9001-2015 dhe 14001, si dhe certifikatat e PRODHUESIT qe produktet dhe elementet janë te pershtatshme ne kontaktet me ujin e pijshem, për të garantuar që elektropompat janë produkte që do të përdoren përfurnizimin me pijshëm të pijëshëm të popullatës.

2.3.5 Deklarata OE e konformitetit për pompën dhe për motorin elektrik zhytes, shoqeruar me Certifikata e kalibrit të instrumentit të laboratorit të testimit të prodhuesit (matës të rrjedhës, manometra, vakum metraWatt-metro, etj.), Nga një kalibrim i fundit nga institutet anëtarë të "Europeanco-operation for Accreditation" (EA).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërmë a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,

Duke qënë se Autoriteti Kontraktor është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi është në të drejtën e tij të garantohet se oe pjesëmarrës dëshmojnë që mallrat e furnizuara janë testuar në bango proven e prodhuesit. Pra nëpërmjet këtij kriteri AK fiton siguri se oe kontraktues do të përbushë me sukses kontratën.

2.3.6 Për të dëshmuar se i plotësojnë kërkesat teknike për mallrat e kërkuara të përcaktuara në DT shtojca 5 Specifikimet teknike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin **katalogë teknike (data sheet)** origjinal nga prodhuesi , **për të gjitha pajisjet** përkatëse objekt prokurimi, ku të tregohen qartë se karakteristikat teknike , janë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor , ku theksojmë që për elektropompat dhe pajisjet e komandimit softstarter dhe inverter, te pasqyrohet ndër të tjera rendimenti i eficiencës në % sipas specifikimeve teknike.

V. Lubonja

R.Rezhda



Pjesët e katalogut të paragitura duhet të janë në gjuhën shqipe ose të janë të përkthyer dhe të noterizuara në gjuhën shqipe.

Argumentim: Ky kriteri është vendosur nga ana e AK në zbatim të kërkesave që përcakton ligji nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” me ndryshime , VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” me ndryshime, neni 40, pika 6, gëрма ”b”.

Plotësimi i këtij kriteri garanton ekzekutimin e objektit të kontratës në përputhje me specifikimet teknike të DT.

2.3.7 Për të dëshmuar se i plotësojnë kërkesat teknike për mallrat e kërkuara të përcaktuara në DT shtojca 5 Specifikimet teknike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin **skemën elektrike** origjinale nga prodhuesi, të pajisjeve të komandimit softstarter dhe inverter, të cilat të tregojnë qartë se janë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor.

Argumentim: Ky kriteri është vendosur nga ana e AK në zbatim të kërkesave që përcakton ligji nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” me ndryshime , VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” me ndryshime, neni 40, pika 6, gëрма ”b”.

Plotësimi i këtij kriteri garanton ekzekutimin e objektit të kontratës në përputhje me specifikimet teknike të DT.

2.3.8 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë:

1 (një) Inxhinier mekanik.

Shënim: Për këtë pikë operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e VETËDEKLARIMIT sipas shtojcës nr.8.

Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorezojë pranë AK, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit**, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përbledhës të vetëdeklarimit. Për të dëshmuar përbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentat provues :

Kontratën e punës me periudhë vlefshmërie që të përfshijë afatin e realizimit të kontratës, si dhe Diplomën e inxhinierit mekanik.

V. Lubonja



R.Rezhda



Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë te kontraktuar një inxhinier mekanik për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përbushur kontratën.

Kërkesa për disponimin e një inxhinieri mekanik është vendosur sepse ai do të shërbejë për zbatimin e instalimeve të pajisjeve sipas kontratës.

2.3.9 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë një staf punonjësish prej minimalisht 5 persona fuqi puntore.

Shënim: Për këtë pikë operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e VETËDEKLARIMIT sipas shtojcës nr.8.

Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorezojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përbledhës të vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues për të dëshmuar përbushjen e këtij kriteri, që operatori ekonomik fitues duhet të paraqesë:

Listpagesat e sigurimeve shoqërore të konfirmuara nga organet tatimore, për periudhën kohore : Nëntor 2022 –Dhjetor 2022- Janar 2023, për punësimin e mesatarisht 5 personave”

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përbushur kontratën.

Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje Nëntor 2022 –Dhjetor 2022- Janar 2023 tregon besueshmëri për autoritetin kontraktor që, operatori do të përbushë kontratën. **Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore** të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit.

V. Lubonja



R.Rezhda



2023

Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës.

Kërkesa për disponimin e 5 punonjësve është vendosur sepse keta punonjës do te sherbejnë për instalimin e pajisjeve elektromekanike dhe për larje e testim pusi, para instalimit.

Periudha kohore e listpagesave të sigurimeve shoqërore është përcaktuar periudha Nëntor 2022 –Dhjetor 2022- Janar 2023, në mënyrë që kriteri të përfshijë një periudhë sa më koherente.

Vlerësohet domosdoshmëria e stafit të punësuar për një periudhë të mëparshme, periudhën: Nëntor 2022 –Dhjetor 2022- Janar 2023, duke argumentuar se kjo shërben si tregues i një marrëdhënie të besueshme e të qëndrueshme midis punëdhënësit e punëmarrësit.

2.3.10 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Mjetet	Statusi	Sasia
Autosondë (për zhbllokimin e mbetjeve të aluvioneve të pusit dhe uljen dhe ngritjen e tubave të solucionit)	në pronësi ose me qira	Copë 1
Kompresor (për futjen me presion të ajrit dhe solucionit në pus)	në pronësi ose me qira	Copë 1
Elektropompë zhytëse H=80 m, Q=50 l/sek e pajisur me inverter me fuqi P=55Kw	në pronësi ose me qira	Copë 1
-elektropompë zhytëse H=100 m, Q=6 l/sek e pajisur me inverter me fuqi P=11Kw	në pronësi ose me qira	Copë 1
Matës uji elektromekanik me fllanxha Dn200mm dhe Dn 100mm me dalje (4-20mA)	në pronësi ose me qira	Copë 1
Aparat me matje diagrame	në pronësi ose me qira	Copë 1
Kompjuter ose Laptop	në pronësi ose me qira	Copë 1
Aparat për ngjitjen e tubave plastike (poletielen për ngjitje ballore)	në pronësi ose me qira	Copë 1

V. Lubonja

R.Rezhda

Shënim: Për këtë pikë operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e VETËDEKLARIMIT sipas shtojcës nr.8.

Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorezojë pranë AK, **përpala publikimit të njofteve të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit**, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përbledhës të vetëdeklarimit.

Dokumentacioni provues për të dëshmuar përbushjen e këtij kriteri, që operatori ekonomik fitues duhet të paraqesë:

a) *Për mjetet ne pronesi, dokumenta provues te tilla si: fature blerje apo deklarate doganore*

Për mjetet e siguruara me qera duhet të paraqitet: a) Mjetet të shoqerohen me kontraten perkatese te qerase/furnizimit, e vlefshme per te gjithe periudhen e realizimit te kontrates, objekt i ketij prokurimi.

b) *Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilen pajisje të deklaruar .*

Autoriteti Kontraktor UKRK SH.A rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara nga OE.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përbushur kontratën.

Lloji dhe sasia e mjeteve të kërkua të është përcaktuar në raport (në përpjestim) me instalimet që do të kryhen, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Mjetet :-autosondë (për zhbllokin e mbetjeve të aluvioneve të pusit dhe uljen dhe ngritjen e tubave të solucionit);

-kompresor (për futjen me presion të ajrit dhe solucionit në pus), nevojiten për larjen e puseve, para instalimit të mallrave.

Larja e puseve:

a)Vendodhja e puseve: Pusi në Stacionin e Pompimit Bulgarec; Pusi nr.2 në Stacionin e Pompimit Plasë ;

V. Lubonja

R.Rezhda

b)Gjendja e puseve : Pusi në Stacionin e Pompimit Bulgarec është hapur ne vitin 2008 dhe prej kësaj kohe nuk është kryer asnjëherë ndërhyrje për pastrimin e tij.

Duke marre parasysh gjëndjen gjeologjike të strukturës së tokës në këtë zone të përbërë nga shtresa rëre dhe zhavorre të imta duhet bërë pastrimi i pusit me ajër dhe solucion larës.

Në stacionin e pompimit Plasë pus shpimet për fshtin Pojan janë ndërtuar ne vitin 2012. Prej këtij momenti asnjëherë nuk është bërë larja dhe pastrimi i tyre. Në këto 3 puse , pusi nr. 2 për shkak të shtresave argjilore uji her pas here turbullohet dhe ka dalë jashtë pune.

c)Të dhënrat e puseve:

-Pusi Bulgarec .Thellësia, H=80 m,diametri i tuave të çelikut,d=300 mm.

-Pusi nr.2 Plasë. Thellësia,H=100 m,diametri i tuave të çelikut,d=160 mm.

Nevojitet të bëhet dhe testimi i puseve , përpara instalimit të elektropompës zhytëse :

Për shkak të shfrytëzimit pa kriter të ujerave nëntokësore dhe për shkak të rënies të paket të shirave dhe dëborës (efekt i ngrohjes globale në 10-vjecarin e fundit) këto puse kanë ulur rendimentin e ujit prandaj nevoitet testimi i tyre për të përcaktuar thellësinë e elektropompës me poshtë, për të rimarë përseri të njëjtën sasi uji.

Paisjet e nevojshme për të bërë testimin e puseve janë:

-elektropompë zhytëse H=80 m, Q=50 l/sek e pajisur me inverter me fuqi P=55Kw ;

-elektropompë zhytëse H=100 m, Q=6 l/sek e pajisur me inverter me fuqi P=11Kw .

(Elektropompat shërbejnë për të matur sasinë minimale dhe maksimale të ujit në pus. Paneli Inverter shërben për t'iu përshtatur sasisë të ujit që do japë pusi).

Matës uji elektromekanik me fllanxha Dn200mm dhe Dn 100mm me dalje (4-20mA)
Matësi i ujit duhet elektromekanik për të matur ujin me saktësi dhe për të hedhur të dhënrat në kompjuter .

Aparat me matje diagrame.

Shërben për të matur uljen e nivelit të ujit në pus dhe për ta lidhur me kompjuterin.


Kompjuter ose (Laptop)

Nevojitet për të nxjerrë kurbën dhe për të përcaktuar sasinë (Q) dhe thellësinë(H) të ujit në pus.

Aparat për ngjitjen e tubave plastike (poletielen për ngjitje ballore)

(Shënim: përcaktoni aktin ligor apo nënligor,në bazë të të cilit është bërë përllogaritja teknike e numrit të punonjësve dhe mjetet/makineritë/pajisjet e nevojshme për zbatimin e kontratës)

V. Lubonja



R.Rezhda



Shënim: Autoretiti /enti kontraktor mund të kërkojë edhe:

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1.

.....
.....
....

(Shënim: Autoriteti/enti kontraktor, në varësi të natyrës së objektit të prokurimit, mund të përcaktojë kritere të tjera të vecanta, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës, duke argumentuar teknikisht dhe ligjërisht çdo kriter, duke përcaktuar, sipas rastit, aktin ligjor/nënligjor që parashikon domosdoshmérinë e kriterit në fjalë).

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuar, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", duke argumentuar çodokërkësë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".

Kujdes:Në specifikimet teknike, nese nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve e mjafueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tillë duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".

Furnizim dhe instalim pompa dhe pajisjesh elektro-mekanike, në Stacionet e fshatrave Vreshtas, Veliternë, Kishnik (Podgorie), Shëngjergj, Plasë, si dhe në Stacionet Rajonale Plasë (Nj.A Pojan) dhe Bulgarec (Nj.A Libonik)."

V. Lubonja

R.Rezhda

Istalimet e Elektropompave dhe Paneleve elektrike

Nr.	Nr. Analize	Emërtimi i punimeve	Njësia	Sasia
I		Stacioni i pompave Zvirinë për në Vreshtas		
		Furnizimi dhe Istalimet e Elektropompave dhe paneleve elektrike.		
1	An	F.V.Elektropompe Horizontale.H=160m,Q=5 l/s	copë	2.00
2	An	F.V.Panel Elektrik me Softstarter.P=30 kw	copë	2.00
II		STP Zvirinë për në Veliterne		
		Furnizimi dhe Istalimet e Elektropompave dhe paneleve elektrike.		
1	An	F.V.Elektropompe Horizontale.H=85m,Q=5 l/s.	copë	1.00
2	An	F.V.Panel Elektrik me Softstarter.P=15 kw	copë	1.00
III		Stacioni i pompave Shëngjergj		
		Furnizimi dhe Istalimet e Elektropompave dhe paneleve elektrike.		
1	An	F.V.Elektropompe Vertikale.H=178m,Q=6 l/s	copë	2.00
2	An	F.V.Panel Elektrik me Softstarter.P=18,5 kw	copë	2.00
IV		STP Sheqeras (Per fshatin Sheqeras)		
		Furnizimi dhe Istalimet e Elektropompave dhe paneleve elektrike.		
1	An	F.V.Elektropompe Horizontale.H=50m,Q=15 l/s.	copë	3.00
2	An	F.V.Panel Elektrik me Softstarter.P= 15 kw.	copë	3.00
V		STP Plasë (Për fshatin Plase)		
		Furnizimi dhe Istalimet e Elektropompave dhe paneleve elektrike.		
1	An	F.V.Elektropompe Horizontale.H=160m,Q=5 l/s.	copë	1.00
2	An	F.V.Panel Elektrik me Softstarter.P=30 kw	copë	1.00
VI		STP Plasë (Për fshatin Pojan)		
		Furnizimi dhe Istalimet e Elektropompave dhe paneleve elektrike.		
1	An	F.V.Elektropompe Horizontale.H=60m,Q=15 l/s	copë	2.00

2	An	F.V.Panel Elektrik me Softstarter.P=18,5 kw	copë	2.00
VII		STP Kishnik per fshatrat (Kishnik dhe Podgorie)		
		Furnizimi dhe Istalimet e Elektropompave dhe paneleve elektrike.		
1	An	F.V.Elektropompe Horizontale.H=350m,Q=14 l/s.	copë	1.00
2	An	F.V. Pompe Horizontale.H=350m,Q=14 l/s.	copë	1.00
3	An	F.V.Elektropompe Horizontale.H=50m,Q=7 l/s.	copë	1.00
4	An	F.V.Panel Elektrik me Inverter.P=75 kw	copë	1.00
5	An	F.V.Panel Elektrik me Inverter.P=7,5 kw(me sensor presioni 4-20ma)	copë	1.00
VIII		STP Bulgarec (Per Rajonin Lumalas-Libonik)		
		Furnizimi dhe Istalimet e Elektropompave dhe paneleve elektrike.		
1	An	F.V.Elektropompe Horizontale.1450 rpm,H=120m,Q=30 l/s.	copë	1.00
2	An	F.V.Elektropompe Horizontale.H=100m,Q=12 l/s.	copë	1.00
3	An	F.V.Elektropompe Zhytse.H=50m,Q=40 l/s.	copë	1.00
4	An	F.V.Panel Elektrik me Inverter.P=75 kw	copë	1.00
5	An	F.V.Panel Elektrik me Softstarter.P=22 kw	copë	1.00
6	An	F.V.Panel Elektrik me Softstarter.P=15 kw	copë	1.00

ISTALIMET HDRAULIKE DHE ELEKTRIKE QË SHOQËROJNË VENDOSJEN E ELEKTROPOMPAVE DHE PANELEVE ELEKTRIKE.

Nr.	Nr. Analize	Emërtimi i punimeve	Njësia	Sasia
I		Stacioni i pompave Zvirinë për në Vreshtas		
		Materiale hidraulike dhe elektrike.		
1	4.88	F.V. Tuba Inoksi SS304,Dn 114mm,Pn16.	kg	300.00
2	An	F.V. Bryla Inoksi SS304,Dn 114mm,Pn16.	copë	4.00
3	An	F.V. Ti Inoksi SS304,Dn 114mm,Pn16.	copë	4.00

2023

4	4.115/7	F.V. Fllanxha Inoksi SS304,Dn 114mm,Pn16.	copë	8.00
5	An	F.V. Tapa Inoksi SS304,Dn 114mm,Pn16.	copë	2.00
6	4.124/4	F.V.Saraqineska me fllanxha ,Dn 114mm,Pn16.	copë	3.00
7	An	F.V. Manometër SS304 me glicemine.Pn25	copë	2.00
8	An.	F,V,Spiral per barobeter,dhe saraqineske 1/2"	copë	2.00
9	An	F.V. Valvul thithse me filter ,d=100 mm,Pn 10.	copë	1.00
10	An	F.V. Kundravalvul me fllanxha,d=100 mm,Pn16	copë	3.00
11	An	F.V. Sahat uji mekanik Dn100mm,Pn16	copë	1.00
12	An	F.V. Filter uji Dn100mm,Pn16	copë	1.00
13	An	FV Xhunto cmontimi,Dn100mm,Pn16	copë	1.00
14	An	Kabell kundra ujit i gomuar H07RN-F, Cu=4x10mm	ml	40.00
15	An	Kabell kundra ujit i gomuar H07RN-F, Cu=3x1,5mm	ml	40.00
16	An	Diota per nivelin e ujit	copë	6.00
17	An	Celes presioni elektromekanik	copë	2.00
18	An	Sistem Karikim per tubin e thithjes dhe shkarkimi per linjen e dergimit	copë	1.00
II				
STP Zvirinë për në Veliterne				
Instalime hidraulike dhe mekanike				
1	4.88	F.V. Tuba Inoksi SS304,Dn 114mm,Pn16.	kg	200.00
2	An	F.V. Bryla Inoksi SS304,Dn 114mm,Pn16.	copë	2.00
3	An	F.V. Ti Inoksi SS304,Dn 114mm,Pn16.	copë	2.00
4	4.115/7	F.V. Fllanxha Inoksi SS304,Dn 114mm,Pn16.	copë	4.00
5	An.	F.V. Tapa Inoksi SS304,Dn 114mm,Pn16.	copë	1.00
6	4.124/4	F.V.Saraqineska me fllanxha ,Dn 114mm,Pn16.	copë	1.00

2023

7	An	F.V. Manometër SS304me fush te madhe me glicemine.Pn25	copë	1.00
8	An.	F,V,Spiral per barobeter,dhe saraqineske 1/2"	copë	1.00
9	An	F.V. Valvul thithse me filter metalike,d=100 mm,Pn 10.	copë	1.00
10	An	F.V. Kundravalvul me fllanxha,d=100 mm,Pn16	copë	1.00
11	An.	F.V. Sahat uji mekanik Dn100mm,Pn16	copë	1.00
12	An.	F.V. Filter uji Dn100mm,Pn16	copë	1.00
13	An.	F.V. Xhunto Cmontimi Dn100mm,Pn16	copë	1.00
14	An	Kabell kundra ujit i gomuar H07RN-F, Cu=4x6mm	ml	30.00
15	An	Kabell kundra ujit i gomuar H07RN-F, Cu=3x1,5mm	ml	20.00
16	An	Diota per nivelin e ujit	copë	3.00
17	An	Celes presioni elektromekanik	copë	2.00
18	An	Sistem Karikim per tubin e thithjes dhe shkarkimi per linjen e dergimit	copë	1.00
III Stacioni i pompave Shëngjergj				
Instalime hidraulike dhe mekanike				
1	4.88	F.V. Tuba Inoksi SS304,Dn 114mm,t=4 mm	kg	300.00
2	An	F.V. Bryla Inoksi SS304,Dn 114mm,Pn20	copë	4.00
3	An	F.V. Ti Inoksi SS304,Dn 114mm,Pn20.	copë	4.00
4	4.115/7	F.V. Fllanxha Inoksi SS304,Dn 114mm,Pn25.	copë	8.00
5	An	F.V. Tapa Inoksi SS304,Dn 114mm,Pn25.	copë	2.00
6	4.124/4	F.V.Saraqineska me fllanxha ,Dn 114mm,Pn 25.	copë	3.00
7	An	F.V. Manometër SS304 me glicemine.Pn25	copë	2.00
8	An.	F,V,Spiral per barobeter,dhe saraqineske 1/2"	copë	2.00
9	An	F.V. Valvul thithse me filter,d=100 mm,Pn 10.	copë	1.00
10	An	F.V. Kundravalvul me fllanxha,d=100 mm,Pn16	copë	3.00

11	An	F.V. Sahat uji mekanik Dn100mm,Pn16	copë	1.00
12	An	F.V. Filter uji Dn100mm,Pn16	copë	1.00
13	An.	F.V. Xhunto Cmontimi Dn100mm,Pn16	copë	1.00
14	An	Kabell kundra ujit i gomuar H07RN-F, Cu=4x6 mm	ml	40.00
